



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 13/67 Prot

Shkodër, më 30.06.2025

VENDIM

Nr. 727 datë 30.06 2025

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”; ligjit nr.89 datë.22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; ligjit nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; Udhëzimit nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Alban Preka me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër;
 - për firmosje si nëpunës autorizues.
 - për firmosje si titullar i autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik.

për të gjithë administratën bashkisë Shkodër.
 - për firmosje shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ, për të gjitha drejtorite duke përjashtuar strukturat e deleguar sipas vendimit nr.188, datë 29.05.2025 dhe vendimit nr.226, datë 30.06.2025.
- 1.1 Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, z.Alban Preka me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/fizik dhe individ për:
 - Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

2. Zv/Kryetari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
3. Kompetencat e deleguara sipas këtij vendimi do të ushtrohen duke filluar nga data 01.07.2025 dhe përfundojnë me datë 31.07.2025, ora 16.00.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Alban Preka dhe administrata bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

